



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .04.2024

MBLEDHJA Nr. 13,
Datë 02.05.2024, ora 12:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 02.05.2024, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 13 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 29.04.2024.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë FTL sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë Dragobia Energy sh.p.k.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “Greennat Solar Park Ballsh” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr.155, datë 07.10.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “Mateo & CO” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Murasi”, me kapacitet të instaluar 2000 kW, në lumin e Cemit të Selcës, degë e lumit Cem i bashkuar, në Bashkinë Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.
5. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 9, datë 21.01.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Breçani R.O.S.P” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “DRITA”, me kapacitet të instaluar 1980 kW, i ndryshuar.
6. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 249, datë 13.12.2021, i ndryshuar, në lidhje me plotësimin e kushteve të licencimit nga shoqëria “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k.
7. Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2024.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola SADUSHI